



Në bazë të dispozitave të nenit 5, paragrafit 5.2, të nenit 16 të Ligjit nr. 03/L-087, për ndërmarrjet publike (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, më 31/15 qershor 2008), Komisioni komunal i aksionarëve për ndërmarrjen publike lokale “Kuzhina Qendore” SH.A. në mbledhjen e datës 03. 08. 2020 merr këtë:

V E N D I M

I.

MIRATOHET Vendimi për shpalljen e konkursit publik për katër (4) pozita për anëtarë të bordit të drejtorëve në Ndërmarrjen Publike Lokale “Kuzhina Qendrore” SH.A.

II.

Konkursi shpallet së paku në një (1) gazetë të përditshme në Republikën e Kosovës, si dhe në faqet zyrtare të Komunës së Prishtinës.

III.

Konkursi duhet të përmbajë kriteret dhe kualifikimet e përcaktuara me Ligjin nr. 03/L-087, për ndërmarrjet publike, Ligjit nr. 05/L-009 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-111, Ligjit nr. 06/L-016 për shoqëritë tregtare, si dhe Statutit të ndërmarrjes publike lokale “Kuzhina Qendore” SH.A.

IV.

Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

U dorëzohet:

- NPL “Kuzhina Qendrore” Sh.A.;
- Në dosje.

Anëtarët e komisionit komunal të aksionarëve:

Naim Jakaj

Fiknete Bejta

Mustafë Krasniqi